

## STATUTI

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### ALBANIAN MARKETING ACADEMY SHPK

Ne Tirane, sot me date 23 Mars 2022, me zbatim te Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", I ndryshuar, si edhe te Ligjit nr. 131/2015 "Per qendren Kombetare te Biznesit", vendoset te krijohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar Albanian Marketing Academy shpk, nga ortaket e saj:

- **Z. Erald Xhuti**, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me 10.04.1993, mbajtes i Leternjoftimit me nr. personal J30410060B dhe nr. 030989617, banues ne adresen : *Rr. Ndre Mjeda, pallati 1, shkalla 5, ap 58;*
- **Z. Enea Doku** shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me 05.01.1996, mbajtes i Leternjoftimit me nr. Personal J60105079D dhe nr. 032462351, banues ne adresen: *Rruga Myslym Shyri, pallati Kastrioti C, Hyrja 7, ap 35.*

#### NENI 1

##### EMERTIMI I SHOQERISE

- 1.1 **Albanian Marketing Academy shpk** eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, themeluar sipas legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.
- 1.2 Aktiviteti I kesaj shoqerie rregullohet nga ky statut dhe nga Ligji nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", I ndryshuar.
- 1.3 Emertimi tregtar I shoqerise eshte "Albanian Marketing Academy" shpk.
- 1.4 Shoqeria fiton personalitet juridik ne momentin e regjistrimit te saj prane Qendres Kombetare te Biznesit.

#### NENI 2

##### SELIA E SHOQERISE

- 2.2 Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: *Rruga Pjetër Bogdani Nd 10, H 5, Kati 1, Apt 1, Tirane, Shqiperi.*
- 2.3 Shoqeria mund te hape zyra perfaqesimi, dege ose filiale dhe ose te marre pjese ne shoqeri te tjera, te kryeje aktivitet ne vende te tjera, Brenda apo jashte territorit te Shqiperise, ne perputhje me vendimmarrjen e ortakeve.

#### NENI 3

##### KOHEZGJATJA

- 3.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne regjistrin tregtar prane Qendres Kombetare te Biznesit.

#### NENI 4

##### OBJEKTI I AKTIVITETIT

- 4.1 Objekti I veprimtarise se shoqerise do te perfshije: *Organizimi i trajnimeve dhe ofrim I sherbimeve ne fushen e Marketingut Dixhital, duke perfshire te gjitha deget e saj, si p.sh.*

*Social Media Marketing, Email Marketing, Online Advertising, eCommerce, Grafik Dizajn, Fotografi, Video, Gjuhe Programimi, Shitje Online, Network Marketing, Team Building, Shitje dhe Reklamim, Leadership, Blogging, SEO, Affiliate Marketing, Content Marketing, Video Marketing, Search & Display Marketing, Business Strategies, Wordpress, Shopify, dhe te tjera, ne gjuhen Shqipe dhe gjuhe te tjera. Trajnimet mund te zgjidhen te ndiqen fizikisht ne ambientet e shoqerise, ose online dhe mund te kryhen ne grup ose te personalizuar. Menaxhim i rrjeteve sociale, ndertim website, ndertim fushatash marketingu, sherbime video dhe fotografi. Çdo veprimtari tjetër që ka lidhje të drejtperdrejte ose të terthorte me veprimtarine kryesore.*

## **NENI 5 KAPITALI**

5.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10.000 Lek (dhjete mije Leke).

5.2 Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

- **ERALD XHUTI** : Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 5000 Lek qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise ;
- **ENEA DOKU**: Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 5000 Lek qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise ;

5.3 Kapitali I regjistruar perbehet nga dy kuota, me pjesemarrje:

- 1 kuote qe perben 50% te kapitalit te shoqerise ne pronesi te ortakut **Erald Xhuti** ;
- 1 kuote qe perben 50% te kapitalit te shoqerise ne pronesi te ortakut **Enea Doku**;

## **NENI 6 KUOTAT DHE TRANSFERIMI**

6.1 Kuotat jane te transferueshme dhe mund te transferohen ne cdo kohe ne perputhje me kushtet dhe afatet qe percaktohen nga ligji ne fuqi,

6.1 Pergjegjesia e ortakut eshte deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin e shoqerise.

6.3 Krahas ecurise se veprimtarise se shoqerise, si edhe te mundesive ekonomiko-financiare qe do te krijohen, kontributet e saj mund te jene edhe ne nature (pasuri te paluajtshme apo te luajtshme), sic mund te vendoset ne te ardhmen nga Asambleja e pergjithshme e shoqerise.

6.4 Kapitali i shoqerise do te rritet ose do te zvogelohet ne perputhje me ecurine e veprimtarise se saj ekonomiko-financiare dhe tregtare, si edhe te vendimeve qe do te ndermarre ne te ardhmen Asambleja pergjithshme e shoqerise.

## **NENI 7 ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT**



7.1 Ne perputhje me kushtet dhe ecurine e veprimtarise se shoqerise, si edhe te vendimeve qe do te merren nga organet e saj, shoqeria mund ta zmadhoje ose ta zvogeloje kapitalin ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

7.2 Zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit regjistrohen ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe kudo qe do te jete e nevojshme.

## **NENI 8 ORGANET E SHOQERISE**

8.1 Organet drejtuese te shoqerise jane :

- **Asambleja e pergjithshme**
- **Administratori**

8.2 Fusha e veprimit dhe kompetencat e organeve specifikohen ne dispozitat e meposhtme.


## **NENI 9 ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**

9.1 Asambleja e pergjithshme eshte organi me i larte i shoqerise. Ajo perbehet nga ortaket e saj:

- Erald Xhuti dhe Enea Doku

9.2 Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- ç) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- i) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.



**NENI 10**  
**MBLEDHJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME**

10.1 Asambleja e pergjithshme mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligji apo statuti, dhe sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise. Mbledhja e zakonshme e asamblese se pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit.

10.2 Asambleja e pergjithshme thirret nga administratoret apo ortaket sipas parashikimeve te ligjit per shoqerite tregtare.

10.3 Asambleja e pergjithshme thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

10.4 Asambleja e pergjithshme thirret kur shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

10.5 Asambleja e pergjithshme thirret kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

**NENI 11**  
**MENYRA E THIRRJES**

11.1 Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

11.2 Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullise.


**NENI 12**  
**MARRJA E VENDIMEVE**

12.1 Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te ortakeve pjesemarres, siç percaktohet ne piken 1 te nenit 86 ligjit, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

12.2 Per çeshtjet e tjera te renditura ne nenin 81 te ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres.

12.3 Vendimet, qe percaktojne detyrime shtese mbi ortaket, apo vendimet qe kufizojne te drejtat e tyre, kushtezohen nga miratimi i ortakut perkates.

**NENI 13**  
**ADMINISTRATORI**



Emerimi, shkarkimi, te drejtat dhe detyrimet


- 13.1 Asambleja e pergjithshme emerone si administrator te shoqerise **Z. Erald Xhuti, I biri I Kimetit, lindur me 10.04.1993 dhe banues ne Tirane, identifikuar me ID me nr. personal J30410060B. me afat 3 vjecar, deri me 30 Mars 2025.**
- 13.2 Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.
- 13.3 Administratori ka te drejte e detyrohet te:
  - a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
  - b) perfaqesoje shoqerine tregtare ne marredheniet me pale te treta;
  - c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
  - ç) pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, sebashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, t'i paraqese keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
  - d) krijojte nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
  - dh) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit;
  - e) raporton perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
  - e) kryen detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.
- 13.4 Ne rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 te nenit 82 te ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite Tregtare", administratoret jane te detyruar te therrasin asamblene e pergjithshme.
- 13.5 Nese asambleja e pergjithshme emerone me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.
- 13.6 Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme.
- 13.7 Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

#### **NENI 14 VITI USHTRIMOR**

- 14.1 Viti ushtrimor fillon ne 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik.
- 14.2 Perjashtimisht viti i pare ushtrimor fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin tregtar Shqiptar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

#### **NENI 15 SHPERNDARJA DHE PRISHJA**

- 15.1 Shoqeria mund te shperndahet me vendim te Asamblese. Shperndarja e shoqerise do te ndiqet nga prishja e saj.
- 15.2 Shoqeria do te ruaje personalitetin juridik per qellime qe lidhen me likuidimin dhe emertimi i shoqerise do te ndiqet nga fjalet « Ne proces likuidimi ».



- 15.3 Likuidatori(et) do te emerohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme. Procesi i prishjes se shoqerise dhe emerimi i likuidatoreve do te kryhet ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
- 15.4 Shkaqet e prishjes se shoqerise  
Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar priset:  
a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;  
b) me vendim te asamblese se pergjithshme;  
c) me hapjen e procedurave te falimentimit;  
ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";  
d) me vendim te gjykates;

**NENI 16**  
**LIGJI I ZBATUESHEM**

- 16.1 Shoqeria do te kryehe dhe zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe me dispozitat ligjore ne fuqi te legjislacionit shqiptar.
- 16.2 Aplikimi i ligjit « Per tregtaret dhe shoqerite tregtare » do te jete ne perputhje dhe per sa nuk eshte parashikuar ndryshe ne kete statut.
- 16.3 Ne rast se nuk eshte parashikuar ndryshe ne kete statut, i aplikueshem do te jete ligji « Per tregtaret dhe shoqerite tregtare », i ndryshuar.

**NENI 17**  
**ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

- 17.1 Cdo mosmarreveshje qe mund te linde ne lidhje me zbatimin ose intepretimimin e ketij statuti si edhe qe mund te linde midis shoqerise dhe paleve te treta, do te zgjidhen nga Gjykatat Kompetente ne Republiken e Shqiperise.

**NENI 18**  
**NDRYSHIMET E STATUTIT**

- 18.1 Ky statut mund te ndryshohet, amendohet dhe/ose shfuqizohet teresisht ose pjeserisht dhe te zevendesohet me nje statut te ri, vetem me vendim te Asamblese se shoqerise dhe ne perputhje me parashikimet e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Ky statut u hartua sot me date 23 Mars 2022, ne seline e shoqerise ne Tirane.

**ORTAKET E SHOQERISE**

**Erald Xhuti**



**Enea Doku**

